

## FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

### Ujësllës Kanalizime Durrës Sh.a

Durrës, 19/08/2020

#### “Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti”

Për: **Krijon sh.p.k**, me NIPT: K12023001A, me adresë: Rruga e Elbasanit, Farke, Tirane.

Procedura e prokurimit: “E hapur-Mallra”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **Nr. REF - 60444-06-08-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

- Objekti: **“Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti”**
- Fondi limit: **9'906'843,33 (nente milion e nenteqind e gjashtë mijë e teteqind e dyzet e tre presje tridhjetë e tre) leke pa tvsh.**
- Burimi i të ardhurave: Te ardhurat e U.K.D Sh.a
- Kohezgjatja e kontratës: **40 dite kalendarike nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës sipas kërkesës së Ak**
- Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë 2 (dy) ofertues si më poshtë:

**1. Krijon sh.p.k, me nipt K12023001A, me vlerë të ofruar:**

- pa TVSH është 9'733'890 (nente milion e shtateqind e tridhjetë e tre mijë e teteqind e nentëdhjetë) lekë.
- me TVSH është 11'680'668 (njembedhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tete) lekë

**2. BO “Albuji” shpk, me nipt K64112206J dhe Ndertimi shpk, me nipt K11325002C me vlerë të ofruar:**

- pa TVSH është 9'480'600 (nente milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë.
- me TVSH është 11'376'720 (njembedhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtateqind e njëzet) lekë

Bo “Albuji” shpk, me nipt K64112206J dhe Ndertimi shpk, me nipt K11325002C është

## **skualifikuar për arsye se nuk përmbush:**

### **Kriteret e vecanta te kualifikimit**

#### **Pika C**

Deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike, nuk eshte sipas shtojces 6;

### **Kapaciteti teknik**

#### **Pika 2**

- Nuk ka paraqitur deklarate apo dokumentacion justifikues per kryerjen e kontrollit te cilesise se analizave me solucione etalone te rekomanduara nga prodhuesi i spektrofotometrave ekzistues ne labororet e UKD dhe te lejoje raportet e kontrollit

#### **Pika 3**

- Nuk ka paraqitur deklarate apo dokumentacion justifikues per kryerjen e testimeve dhe kalibrimeve te pajisjeve nga specialist i trajnuar dhe i autorizuar ose nga kompania prodhuese e pajisjeve ose nga distributore, ente apo pale te treta certifikuese.

#### **Pika 4**

- Nuk ka paraqitur kataloget origjinale te markuar per te gjithë artikujt e ofertuar si edhe autorizimin e prodhuesit ose te distributoret te autorizuar

#### **Pika 6**

- Nuk ka paraqitur deklarate apo dokumentacion justifikues per kurbat e kalibrimit qe te jene te programuara per spektrofotometrin model PhotiLab 7600 (ose ekuivalent)

#### **Pika 7**

- Nuk ka paraqitur manualet e perdorimit ne anglisht dhe shqip per kitet

#### **Pika 8**

- Nuk ka paraqitur deklarate apo dokumentacion justifikues per kitet, qe duhet te jene konform parametrave te percaktuar ne ligjit 9115 date 24/07/2003 “Per trajtimin mjedisor te ujerave te ndotur”, i ligjit 8102 “Per largimin dhe perpunimin e ujerave te ndotur” i amenduar me ligjet 9352 nr. 9584, nr. 9915 por dhe i Vkm 177, date 31/03/2005 “Normat e lejuara lidhur me ceshtjet e shkarkimit te ujerave dhe kriteret zonale te organeve marrese”.

### **Pra kualifikohet Oe Krijon sh.p.k me vlere te ofruar:**

- pa TVSH është 9’733’890 (nente milion e shtateqind e tridhjete e tre mije e teteqind e nentedhjete) lekë.
- me TVSH është 11’680’668 (njembedhjete milion e gjashteqind e tetedhjete mije e gjashteqind e gjashtedhjete e tete) lekë

Duke ju referuar procedures se lartpermendur, informojmë **Krijon sh.p.k** se oferta e paraqitur, me nje vlere te pergjithshme është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujesjelles Kanalizime Durrës sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brënda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 27/07/2020

Gjatë afatit ligjor prej 7 ditësh për pritjen e ankesave nuk pati ankesa.

**ADMINISTRATOR  
ING.SPARTAK KOVAÇI  
PERSONI I AUTORIZUAR  
Z. KASEM BEJKO**